



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, Bashkia Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
42999200-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,958,330 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 39,166.6 (tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar.....”;*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se

operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2025 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore ”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose **ekuivalente**, e vlefshme, të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare ose European Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik të jete i certifikuar për cilësinë. të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklarate që merr persiper, me mjetet e veta, transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e AK, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- b) Operatori ekonomik duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues, mallrat do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklarate për skadencën e mallrave, e cila duhet të jete jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i levritimit të mallit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet të nevojshme për realizimin me

sukses të kontratës sipas kërkesave të AK. Deklaratat e mësipërme janë kërkuar pasi janë të nevojshme për zbatimin e kontratës me sukses dhe cilësi.

2.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) Në rast kur OE nuk është prodhues ai duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi nga një Distributor i Autorizuar për solucionet dhe detergjentet. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi apo Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo kontraktuesit (Distributor i Autorizuar) si: emër, numër nipti, telefon/fax, e-mail/ website, shoqëruar me:
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë (skeda teknike) për të gjithë artikujt e tabelës së mëposhtme, skedat duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Në skedat teknike duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave (specifikimeve teknike) të kërkuara me produktet e ofruara.

Nr. sipas Preventivit	Emertimi
5	Detergjent neutral dyshemeje (bidon 5 lit)
7	Detergjent për xham dhe kristale (bidon 5 lit)
17	Sapun për larje duarsh (leng) (bidon 5 lit)
19	Detergjent universal (zbardhues) (bidon 5 lit)
20	Sgresante universal (bidon 5 lit)
21	Hipoklorit Kalciumi 55-70 %

b) Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mësipërme (nga një mostër për secilin artikull).

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e AK.
- Cdo mostër e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet të detyrimsht të jenë të vëlosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korespondues me emrin e artikullit.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Nëse mostrat nuk janë sipas specifikimeve OE do të skualifikohet.
- Mosparaqitja e mostrave ditën e zhvillimit të tenderit është kusht për skualifikimin e operatoreve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 6 “a”, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të APP-së Nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” Kriteri i vendosur për paraqitjen e Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi si dhe mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit

shoqërues të paraqitur, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontrates.

Shënim: Ne zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.....etj. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.....”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.3848 Prot, datë 20.08.2024 (e cila është bashkëlidhur dosjes).

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Bishta fshese –Te jene prej druri dhe te forte.
Fshesa - Fshesat te kene fije te dendura per fshirje sa me komode te siperfaqeve te ndryshme dhe te jene rezistente gjate forces se fshirjes se siperfaqeve. Te kene fije mesatarisht te gjata dhe teper elastike ne perdorim.
Peshqire pluhurash paketim 3 copesh leckë –Të jenë cilësore, te jene me shume se nje perdorimesh. Te kene veti te mira absorbuese.
Qeska plastike mbeturinash 100kg/pako 10 –Te jene te medha dhe material i forte. Te jene te paketuara ne forme Ruloje pakoja te kete 10 fije , me permasa 70*100 cm .
Detergjent neutral dyshemeje – Te jete i perdorshem per larjedyshemeje, te jete ilengshem. Te permbaje substance. Shume aromat per pastrim te shpejte dhe pa veshtiresi te dyshemese duke hequr gjithë njollat e mundeshme dhe te jete shume i shpejte ne tharje si produkt per te mos lene gjurme dhe aromat kete rreshkitje , ambalazh 5 lit . Etiketimi ne përputhje me rregulloren CE , nr. 1272/2008 .te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit
Doreza pastrimi (plastike) –Të jenë të gomuar, me përbërje të trashë, për larjen e tualeteve, mureve e pllakave, duhet te jene te mases small dhe medium. Duhet te jene jo alergjike per lekuren dhe te jene te pa depertueshme nga lengjet e ndryshme.
Detergjent per larje xhamash dhe kristale - Te jete produkt shume i perqendruar, leng nengjyre te hapur dhe te mos leri njolla ne xham gjate perdorimit. Te jete i perdorshem me te gjitha llojet e fibrave te tekstilit.Te japi nje shkelqim xhamit dhe te thahet shpejte, i ambalazhuar ne ene plastike 5 lit. Etiketimi ne përputhje me rregulloren CE , nr 1272/2008 . te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.
Shtupa larje –Shtupa pambuku per larje dyshemeje, te perbera nga fibra tekstilite buta qe thithin ujin shume mire. Dendesia e shtupes te jete jo me e vogel se 350 gr.
Acid pllakash – Acid me bidona 1 litersh. Te perdoret per mirembajtje te tualetit, te jete leng, shume i perqendruar dhe me nje formuleshume efikase ne heqjen e papastertise dhe njollave apo mikrobeve. Te mos mbaje arome te forte dhe mos te demtojte lekuren e njeriut. Te jete i lehte ne shpelarje me uje.Te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit
Lopate per mbeturina –Te jete ne forme kutie e hapur nga perpara per mbledhjen e papastertive te ndryshme, e pajisur me nje bisht te montueshem dhe çmontueshem.
Kova Larje –Te jene prej kaucuku cilesore me nje kapacitet te mbajtjes jo me pak se 13 l.
Kova plastike me kapak - Kova plastike te thjeshta, te jene rrethore, te thella dhe te kene nje doreze mbajttese nga siper per transportimin e koves me nje kapacitet te mbajtjes jo me pak se 10 l.
Aromatik për larje pllakash – Solucion larës dyshemeje cilësor, me fuqi larese te njollave, të jetë me aromë. Ambalazhimi ne shishe plastike 1 lit , gjendja fizike te jete leng, me arome lulesh. Densiteti i lengut ne aromatikore 20°C te jete jo me i madh se 1,000 +/- 0,005 g/ml. Te jete i tretshem ne uje, te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit.

Kosha te medhenj per mbeturina – Te jene material plastik, cilesore, te pastrohen lehtesisht nga njollat dhe papasterite me nje kapacitet te mbajtjes jo me pak se 50 kg. Koshat duhet te kene nje kapak.
Fshesa merimangash –Te jene me fije te dendura te qendrueshme dhe te forta dhe te kene bisht gjatues deri ne 3 m .
Sapuna –Te jene cilesore, aromatik e me madhesi mesatare. Te jene te tretshem ne uje. Tu jape duarve butesi dhe arome te kendeshme freskie. Te jene jo alergjik per lekuren.
Sapun larje duarsh leng -Te jete cilesore. Tu jape duarve butesi dhearome te kendeshme freskie. Te jete jo alergjik perlekuren , ambalazhi 5 lit . Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE nr. 1272/2008 .te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit
Furca tualeti –Furca per pastrimin e WC, te jene me fije te forta per pastrimin e siperfaqeve te veshtira. Furcat te kene mbajtesen e saj (komplet).
Detergjent universal (zbardhues) - Te jete cilesor,me fuqi larese te njollave. Ambalazhimi 5lit, gjendja fizike te jete leng.Te jete i tretshem ne uje.Te mos mbaje arome te forte dhe mos te demtoje lekuren e njeriut. Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE , nr 1272/2008 . te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit
Sgrasante universal -Te jete me veti per heqjen e yndyrnave ambalazhi 5 lit . Etiketimi ne perputhje me rregulloren CE , nr 1272/2008 , te kete date prodhimi dhe date skadimi jo me pak se 1 vit .
Hipoklorit Kalciumi – Te jete klori aktiv 55-70%, plumbi (pb) 2.2, kadmiumi (cd), kromi (Cr) 1.7, nikeli (ni) 1.9, per pastrim dhe dezinfektim te ambienteve te ndryshme.

Afatet e lëvrimit: Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

- | | |
|-----------------|------------------------------|
| 1. Pjeter Bushi | Kryetar (Përsoni përgjegjës) |
| 3. Rudolf Toma | Anëtar |
| 2. Aurora Buna | Anëtare |